



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

SHKOLLA E MESME TEKNOLOGJIKE "HYSEN ÇELA" DURREËS

Nr. 66 Prot.

Durrës, më 03.09.2024

**Lënda:** Njoftim për vend vakant.

**DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE  
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

**Rruga "Bulevardi Bajram Curri", Tiranë**

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit", të ligjit nr.15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr .554, datë 31.7.2019. "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive", të udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit",

Shkolla e mesme teknologjike "Hysen Çela", ju njofton krijimin e vendit të lire për pozicionin / pozicionet:

Specialist i I ( një ) vend vakant

**A - Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme**

**1. Kriteret të përgjithshme:** a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën; c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale; d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar; e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit; f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

**2. Kriteria të posaçme për specialist finance:** të ketë të paktën diplomë bachelor, në shkencë ekonomike, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës; të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të ngjashme, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës; të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

### **B - Dokumentet e aplikimit**

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë: a - letërmotivimin për pozicionin; b- jetëshkrimin (CV-në); c- kartën e identitetit; d- diplomën; e- librezën e punës; f- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV; g- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit; h- vërtetimin e gjendjes shëndetësore; i- vërtetimin e gjendjes gjyqësore; j- vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi, k - të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Shkolles së Mesme Teknologjike "Hysen Çela", brenda datës ...17.09.2024

**DREJTORE**

**Dr. Blerina DERVISHI**

